

Ahengu familjar në Ferizaj shoqërohet me të shtëna – 20-vjeçari kapet me a*më në brez



Sinjali.com

09 Gusht 2026 11:22



Një aheng familjar në fshatin Mirosalë të Ferizajt është shoqëruar me të shtëna në orët e para të mëngjesit të së dielës, duke bërë që në vendin e ngjarjes të intervenojë Policia.

Sinjali mëson se i dyshuari është Ermal Berisha, rreth 20-vjeçar, i cili dyshohet se ka shtënë gjatë ahengut dhe më pas e ka pranuar këtë para hetuesve.

Rasti ka ndodhur më 9 gusht, rreth orës 00:45, në rrugën “Mejdi Xhaferi”, pasi Policia kishte pranuar informatën se në një aheng familjar po kishte të shtëna.

Njësitë policore kanë dalë menjëherë në lokacion, ku kanë kontaktuar me Berishën. Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, ai ka treguar se familja po mbante një aheng dhe ka pranuar se kishte shtënë me një armë me gaz.

Gjatë intervenimit, Policia i ka konfiskuar të dyshuarit një armë të tipit “Ekol” dhe karikatorin, të cilat i mbante në brez. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar edhe dy gëzhoja.

20-vjeçari është shoqëruar në Stacionin Policor dhe është intervistuar nga hetuesit, ku, sipas raportit të rastit, ka pranuar se kishte shtënë.

Pas konsultimit me Prokurorin kujdestar janë iniciuar rastet për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës” dhe “Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm”.

Pas intervistimit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa rasti vazhdon të trajtohet nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera